



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
 GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
 PRIŠTINA/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 16949 /10

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, GJYQTARJA Fadila Hyseni me pjesmarrjen e sekretares juridike Bahrije Krasniqi , duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Mehdi Polisi nga Prishtina , për kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për deklarativin e ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisl dhe të dhuratave të zyrtarve të lartë publik ,e në bazë të nenit 73,74,195 dhe nenit 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 19.08.2010 merr këtë:

A K T V E N D I M

E PANDEHURA: Mehdi Dilaver Polisi , lindur më 1953 në Stugë , tani jeton në Prishtinë në rr. Matian pa nr.punon në Fakultetin e Filologjisë –funksion e Prodekanit , i martuar , i gjendjes së mesme ekonomike ,

Ë s h t ë p ë r g j e g j e s e

Sepse deri me dt, 31.03.2010 si Zyrtar i lartë Publik –Prodekanik i Fakultetit të Filologjisë Agjencionit për antikorrupsion nuk e ka dërguar formularin për Deklarimin e Pasurisë edhe pse i janë dërguar formalët e Agjencionit për Antikorrupsion .

Me qka ka kryer kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik , andaj për këtë

G J O B I T E T

Me gjobë në shumën prej 1000 (një mijë) € , të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës kur ky aktvendim të merrë formë të prerë, në favor të AFQ të Drejtësisë në xhirollogarinë rrjedhëse 1000430070000518. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 (tridhjet) ditësh, duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) €, për një ditë burgimi. Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqsor i pandehuri është e obliguar që të paguaj shumën prej 5 € në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dorzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Angjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, parashtron kërkesën nr. 01/2306/10 të dt. 08.06.2010 , për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër të lartëpërmendurës dhe për kundërvajtjen e përshtuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtari inicioi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurin i cili deklaroi : në kohën kritike ka qenë i zanun me pregaditjen e një materiali rreth 150 faqe dhe merret me punë në Arsim ku nuk ka tendera as diqka në ngjashme andaj edhe pasuria e tij është tejet e vogël.

Me rastin e shqiptimi të denimit, gjyqtari vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-së, nën të cilat është kryer kundërvajtja dhe të pandehurit ia shqiptoi këtë lloj denimi, duke llogaritur se edhe me këtë do të arrihet efekti i sanksionimit, që i pandehuri në të ardhmen t'i shmanget kryerjes së veprave të këtilla dhe të ngjashme. Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrorj në ankesë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi, nëpërmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

Gjyqtarja
Fadila Hyseni

